

## Burgosja

*Pjesë nga raporti i 2-të i Përgjithshëm,  
publikuar në vitin 1992*

44. Në hyrje, duhet të theksohet se KPT duhet të shqyrtojë shumë çështje kur viziton një burg. Natyrisht, ai i kushton vëmendje të veçantë çdo pretendimi për keqtrajtim të të burgosurve nga personeli. Sidoqoftë, për mandatin e KPT janë me rëndësi të gjitha aspektet e kushteve të mbajtjes në një burg. Keqtrajtimi mundet të marrë forma të shumta, mjaft prej të cilave mund të mos jenë të vullnetëshme por rezultojnë më tepër nga mangësitë organizative ose burimet e papërshtatëshme. Cilësia e përgjithëshme e jetës në një institucion është pra me rëndësi të konsiderueshme për KPT. Ajo cilësi jete do të varet në një masë të madhe nga aktivitetet që u ofrohen të burgosurve dhe gjendja e përgjithëshme e marrëdhënieve ndërmjet të burgosurve dhe personelit.

45. KPT vëren me kujdes atmosferën mbizotëruese brenda institucionit. Promovimi i marrëdhënieve konstruktive në kundërshtim me ato konfrontuese ndërmjet të burgosurve dhe personelit do t'i shërbejë uljes së tensionit të vetvetishëm në çdo mjedis burgu dhe në të njëjtën mënyrë do të ulë mjaft edhe gjasat e incidenteve të dhunëshme dhe keqtrajtimin shoqëruës. Shkurtimisht, KPT dëshiron të shohë të shohë që masat e kontrollit dhe të përmbajtjes të shoqërohen me një frymë komunikimi dhe kujdesi. Një përjasje e tillë jo vetëm që nuk e dëmton sigurinë në institucion, por mundet edhe ta rrisë atë.

46. Mbipopullimi është një çështje me rëndësi direkte për mandatin e KPT. Të gjitha shërbimet dhe aktivitetet brenda një burgu do të ndikoheshin keq në se do të kërkohej të mbaheshin në të më shumë të burgosur nga sa është projektuar të mbajë; cilësia e përgjithëshme e jetës në institucion do të ulej, ndoshta konsiderueshëm. Për më tepër, niveli i mbipopullimit në një burg, ose pjesë të veçantë të tij, mundet të jetë i tillë që të jetë në vetvete çnjerëzor ose poshtëruës nga një pikëvështrim fizik.

47. Një program i kënaqshëm aktivitetesh (punë, edukim, sport, etj.) është me rëndësi kryesore për mirëqenien e të burgosurve. Kjo është e vërtetë për të gjitha institucionet, si për të burgosurit e dënuar ashtu edhe për ata që presin gjykimin. KPT ka vënë re që aktivitetet në shumë burgje për të ndaluar janë skajshëm të kufizuara. Organizimi i aktiviteteve të regjimit në këto institucione – të cilat kanë një qarkullim relativisht të shpejtë të personave që mbahen në to – nuk është një çështje e thjeshtë. Qartësisht, nuk mund të bëhet fjalë për programe trajtimi të individualizuara të llojit për të cilat mund të aspirohet në institucionet për të burgosur të dënuar.

Sidoqoftë, të ndaluarit nuk mund të lihen të vuajnë për javë, e ndoshta muaj, të mbyllur në qeli, pavarësisht se sa të mira mund të jenë kushtet materiale në qeli. KPT konsideron se duhet synuar të sigurohet që të gjithë të ndaluarit në institucionet përkatëse të mund të kalojnë një pjesë të arsyeshme të ditës (8 orë ose më tepër) jashtë qelive, të angazhuar në aktivitete të qëllimshme të

natyrave të ndryshme. Natyrisht, regjimet në institucionet për të burgosurit e dënuar duhet të jenë edhe më të favorshme.

48. Duhet përmendur veçanërisht ushtrimet e ajrimit. Kërkesa që të burgosurit të lejohen të paktën një orë ushtrim nën qiell të hapur çdo ditë pranohet përgjithësisht si garanci bazë (me preferencë kjo duhet të jetë pjesë e një programi më të gjerë aktivitetesh). KPT dëshiron që të thekojë se **të gjithë të burgosurit pa përjashtim** (duke përfshirë ata të ndëshkuar me regjim qelie) duhet të kenë mundësinë të kenë aktivitet ajrimi çdo ditë. Gjithashtu vetëkuptohet që mjediset e ushtrimit në qiell të hapur duhet të jenë arsyeshmërisht të bollshme dhe kurdoherë që është e mundur të ofrojnë strehë për mot të keq.

49. Akses i menjëhershëm në tualet të përshtatshëm dhe mbajtja e një standardi të mirë higjene në to janë përbërës thelbësorë të një mjedisi të njerëzishëm.

Lidhur me këtë, KPT duhet të deklarojë se asaj nuk i pëlqen praktika e hasur në disa vende ku të burgosurit kryejnë nevojat personale në kova në qelitë e tyre (të cilat “nxirren jashtë” në kohë të caktuara). Ose duhet të ketë një tualet në mjedisin e qelisë (me preferencë në një aneks sanitar) ose të ekzistojnë mjetet që t’u mundësojnë të burgosurve që kanë nevojë të përdorin tualetin të dalin nga qelitë e tyre pa vonesë në çdo kohë (përfshirë natën).

Më tej, të burgosurit duhet të kenë mundësi të përshtatshme të bëjnë dushe ose banjë. Është gjithashtu e dëshirueshme të ketë ujë të rrjedhshëm brenda qelisë.

50. KPT do të shtonte se është veçanërisht e shqetësuar kur gjen në të njëjtin institucion një kombinim të mbipopullimit me aktivitete regjimi të varfëra dhe mjedise të papërshtatshme tualeti/larjeje. Efekti përmbledhës i këtyre kushteve mund të jetë skajshëm dëmsjellës për të burgosurit.

51. Është gjithashtu shumë e rëndësishme për të burgosurit të mbajnë kontakt arsyeshmërisht të mirë me botën e jashtme. Mbi të gjitha, të burgosurit duhet t’i jepen mjetet për të ruajtur marrëdhëniet me familjen dhe miqtë e ngushtë. Parimi udhëheqës duhet të jetë nxitja e kontakteve me botën e jashtme; çdo kufizim i kontakteve të tilla duhet të bazohet përjashtimisht mbi shqetësime sigurie të konsiderueshme ose mbi konsiderata burimesh.

KPT dëshiron të theksojë në këtë kuadër nevojën për ca fleksibilitet lidhur me zbatimin e rregullave për vizita dhe kontakte telefonike për të burgosurit familjet e të cilëve jetojnë larg (gjë që i bën vizitat e rregullta jo praktike). P.sh. të burgosurve të tillë mund t’u lejohet të grumbullojnë kohën për vizita dhe/ose t’u ofrohen mundësi të përmirësuara për kontakte telefonike me familjet e tyre.

52. Natyrisht, KPT është gjithashtu e vëmendshme ndaj problemeve të veçanta që mund të hasen nga kategori specifike të burgosurish, p. sh. gratë, të miturit dhe të huajt.

53. Personeli i burgut ndonjëherë duhet të ushtrojë forcë për të kontrolluar të burgosurit e dhunshëm dhe, përjashtimisht, mundet edhe të përdorë instrumente të kufizimit fizik. Këto janë qartë situata me rrezik të lartë përsa i përket keqtrajtimit të të burgosurve, dhe si të tilla bëjnë thirrje për garanci specifike.

Një i burgosur ndaj të cilit është përdorur çfarëdo lloj force duhet të ketë të drejtën të ekzaminohet menjëherë dhe, në se është e nevojshme, të trajtohet nga një mjek. Ky ekzaminim duhet të kryhet pa u dëgjuar dhe me preferencë pa u parë nga personeli jo-mjeksor dhe rezultatet e ekzaminimit (duke përfshirë deklaratat përkatëse nga i burgosuri dhe konkluzionet e mjekut) duhet

të evidentohen zyrtarisht dhe t'i vihen në dispozicion të burgosurit. Në ato raste të rralla kur kërkohet përdorimi i instrumenteve për kufizimin fizik, i burgosuri në fjalë duhet të mbahet nën mbikëqyrje të përshtatëshme dhe të vazhdueshme. Më tej, instrumentet e kufizimit duhet të hiqen në rastin më të parë të mundshëm; ato nuk duhet të përdoren kurrë ose përdorimi i tyre nuk duhet zgjatur kurrë për ndëshkim. Së fundi, duhet të mbahet evidencë për çdo rast të përdorimit të forcës kundër të burgosurve.

54. Procedura efektive ankimi dhe inspektimi janë garanci themelore kundër keq-trajtimin në burgje. Të burgosurit duhet t'i kenë rrugët e ankimit të hapura si brenda ashtu edhe jashtë sistemit të burgut, duke përfshirë mundësinë që të kenë akses konfidencial te një autoritet i përshtatshëm. KPT i kushton rëndësi të veçantë vizitave të rregullta në çdo burg nga një organ i pavarur (p.sh. një bord vizitorësh ose një gjyqtar mbikqyrës) i cili ka kompetenca të dëgjojë (dhe në se është e nevojshme të marrë masa) ankimet nga të burgosurit dhe të inspektojë mjediset e burgut. Organe të tilla mundet ndër të tjera të luajnë një rol të rëndësishëm në urëzimin e divergjencave që lindin ndërmjet drejtuesve të burgut dhe një të burgosuri ose të burgosurve në përgjithësi.

55. Është gjithashtu në interes të të burgosurve dhe të personelit të burgut që procedurat e qarta disiplinore të vendosen zyrtarisht dhe të zbatohen në praktikë; çfarëdo zone e errët në këtë fushë përmban rrezikun që të shihet se po zhvillohen sisteme jo zyrtare (dhe të pakontrolluara). Procedurat disiplinore duhet t'u japin të burgosurve të drejtën të dëgjohen mbi temën e shkeljeve që pretendohet se ata kanë kryer, dhe të ankohen te një autoritet më i lartë kundër masave të vendosura.

Shpesh, krahas procedurës disiplinore zyrtare, ekzistojnë procedura të tjera, nën të cilat një i burgosur mund të ndahet në mënyrë të pavullnetëshme nga të burgosur të tjerë për arsye të lidhura me disiplinën/sigurimin (p.sh. në interes të "rregullit të mirë" në institucion). Këto procedura duhet të shoqërohen gjithashtu me garanci efektive. I burgosuri duhet të informohet për arsyet e masës së marrë kundër tij, përveçse kur kërkesat e sigurimit diktojnë ndryshe<sup>1</sup>, atij duhet t'i jepet një mundësi të paraqesë pikëpamjet e tij mbi çështjen dhe të ketë mundësinë ta kundërshtojë masën para një autoriteti të përshtatshëm.

56. KPT i kushton vëmendje të veçantë të burgosurve, të mbajtur për çfarëdo arsye (për qëllime disiplinore; si rezultat i sjelljes së tyre "të rrezikshme" ose "shqetësuese; për interes të hetimit penal; me kërkesën e tyre), në kushte të ngjashme me izolim të vetmuar.

Parimi i përpjestueshmërisë kërkon të ruhet një ekuilibër ndërmjet kërkesave të çështjes dhe zbatimit të regjimit tip - izolim i vetmuar, i cili është një hap që mund të ketë pasoja shumë të dëmshme për personin në fjalë. Izolimi i vetmuar, në disa rrethana, mund të arrijë në trajtim poshtërues e çnjerëzor; në çdo rast, të gjitha format e izolimit të vetmuar duhet të jenë sa më të shkurtëra që është e mundur.

Në rastin kur një regjim i tillë imponohet ose zbatohet me kërkesë, një garanci thelbësore është që kurdoherë kur i burgosuri në fjalë, ose një nëpunës burgu në emër të tij, kërkon një mjek, mjeku duhet të thirret pa vonesë me synimin që të kryejë një ekzaminim mjekësor të të burgosurit. Rezultatet e këtij ekzaminimi, duke përfshirë edhe një përshkrim të gjendjes fizike dhe mendore, e në se duhet, pasojat e parashikueshme të izolimit të vazhduar, duhet të paraqiten në një deklaratë me shkrim që do t'i jepet autoriteteve kompetente.

---

<sup>1</sup> Kjo kërkesë më vonë është riformuluar si më vijon: i burgosuri duhet të informohet me shkrim për arsyet e masës së marrë kundër tij (duke kuptuar që arsyet e dhëna mundet të mos përmbajnë hollësi që kërkesat e sigurimit justifikojnë të mos i jepen të burgosurit).

57. Transferimi i të burgosurve problematikë është një praktikë tjetër me interes për KPT. Disa të burgosur janë skajshëm të vështirë për t'u trajtuar, dhe ndonjëherë mund të jetë i nevojshëm transferimi i tyre në një institucion tjetër. Sidoqoftë, lëvizja e vazhdueshme e një të burgosuri nga një burg në tjetrin mund të ketë efekte shumë të dëmshme mbi mirëqenien e tij psikologjike dhe fizike. Për më tepër, një i burgosur në një pozicion të tillë do ta ketë të vështirë të mbajë kontakte të përshtatëshme me familjen dhe avokatin e tij. Efekti i përgjithshëm mbi të burgosurin i transferimeve të njëpasnjëshme mundet që në rrethana të caktuara të arrijë në trajtim poshtërues e çnjerëzor.